

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E DUHUR TË LOGOS TUV AUSTRIA

1. Përdorni paraqitjen e duhur sipas certifikimit(ve) të kompanisë suaj, si në shembujt e mëposhtëm:



Është e detyrueshme që lloji i certifikimit dhe numri i regjistrimit të përmenden qartë.

Logoja mund të përdoret në paraqitjen e mësipërme në fatura, postën elektronike të korporatave, reklama, fletëpalosje dhe faqe interneti.

Në rastin e një certifikimi të shumëfishtë (p.sh. ISO 9001 dhe ISO 14001) më shumë se një standard mund të shfaqet brenda së njëjtës shenjë në një renditje vertikale.

2. Përdorime të tjera të logos (afishe, tabela etj.)

2.1 Në zinxhirin e furnizimit

Logoja mund të paraqitet në tabelat e kompanisë si në kamionë etj. në një mënyrë që të nënkuptojë qartë llojin e certifikimit të dhënë duke deklaruar standardin përkatës.

2.2 Në ekspozitat dhe vitrinat e dyqaneve

Ekziston mundësia për të paraqitur certifikatën në tavolinat e pritjes ose dritaret e dyqaneve, si dhe në showroom-e dhe ekspozita duke përdorur afishe, stenda ose mjete të tjera promovuese.

3. Përdorimi i paautorizuar

Logoja nuk duhet të përdoret në një produkt apo paketim produkti dhe as në ndonjë mënyrë tjetër që mund të interpretohet se tregon konformitetin e produktit.

Gjithashtu nuk lejohet të zbatohet nga klientët e certifikuar për t'u vendosur në testet laboratorike, raportet e kalibrimit ose inspektimit apo nëpër certifikatat e tyre.

4. Ngjyrosja e duhur e logos TÜV AUSTRIA

4.1 Katër ngjyra

Në rast se të gjitha ngjyrat janë të disponueshme, logoja riprodhohet në ngjyrë të vërtetë duke përdorur të zezën dhe të kuqen (Magenta 100%+E verdhë 100%, Pantone 032) siç tregohet më poshtë.



4.2 E zezë dhe e Bardhë

Për paraqitjen e logos bardh e zi, shenja e kuqe duhet të shfaqet gri (E zezë 50%, Pantone Cool Grey 8U) siç tregohet më poshtë.



4.3 Një ngjyrë (përveç të zezës)

Nëse ka vetëm një ngjyrë përveç të zezës, të dyja pjesët, e zeza dhe e kuqja e logos riprodhohen në këtë ngjyrë unike siç tregohet më poshtë.



4.4 Në sfond të zi

Nëse logoja do të vendoset në sfond të zi, atëherë pjesët e zeza të logos riprodhohen në të bardhë dhe pjesa e kuqe mbetet e pandryshuar (Magenta 100%+E verdhë 100%, Pantone 032), siç tregohet më poshtë.



Për më shumë informacion dhe mbështetje për përdorimin e logos,
kontaktoni: Departamentin e Certifikimit, tel. +355 44500523/4.